

VENDIM
Nr. 663, datë 27.8.2020

PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË MARRËVESHJES SË KONCESIONIT, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE “ALBCHROME HOLDING” SHPK, SI KONCESIONARI, PËR REHABILITIMIN, OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E MINIERËS SË KROMIT BULQIZË, TË FABRIKËS SË PASURIMIT BULQIZË, TË IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT KLOS DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT BURREL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 11, të ligjit nr. 79/2016, “Për miratimin e shtesës së marrëveshjes së koncesionit, nëpërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, si autoriteti kontraktues, dhe ACR Holding S.r.l., si koncesionari, për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e minierës së kromit, Bulqizë, të fabrikës së pasurimit, Bulqizë, të impiantit të seleksionimit, Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit, Burrel”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e shtesës së marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoritet kontraktues, dhe “Albchrome Holding” sh.p.k., si koncesionari, për rehabilitimin, operimin dhe transferimin e minierës së kromit Bulqizë, të fabrikës së pasurimit Bulqizë, të impiantit të seleksionimit Klos dhe të uzinës së ferrokromit Burrel, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Nr. 426/ Jof.

SHTESË E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT

NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE ALBCHROME HOLDING SHPK, SI KONCESIONARI, PËR REHABILITIMIN, OPERIMIN DHE TRANSFERIMIN E MINIERËS SË KROMIT BULQIZË, TË FABRIKËS SË PASURIMIT BULQIZË, TË IMPIANTIT TË SELEKSIONIMIT KLOS DHE TË UZINËS SË FERROKROMIT BURREL

Kjo shtesë e Marrëveshjes së Koncesionit ("**Marrëveshje**") është nënshkruar në datë 30/06/2020 ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ("**MIE**"), me adresë në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit", Nr.1, Tiranë, Shqipëri (këtu e më poshtë referuar si "**Autoriteti Kontraktues**") përfaqësuar me autorizim nga Z. Ilir Bejtja dhe Albchrome Holding shpk, përfaqësuar nga Znj. Blerina Daka, (këtu e më poshtë referuar si "**Koncesionari**"). Secili prej **Autoritetit Kontraktues** dhe **Koncesionarit** do të quhen individualisht "**Palë**" dhe bashkërisht "**Palët**".

MEQENËSE:

- A. Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (MEPP) dhe Darfo s.p.a, më datë 14.04.2001, është firmosur një Marrëveshje Koncesioni e formës ROT ("**Marrëveshja e Koncesionit**"), e cila më pas u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin Nr. 8791, datë 10.05.2001 "*Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës ROT të minierës së kromit Bulqizë, të fabrikës së pasurimit Bulqizë, të impiantit të seleksionimit Klos dhe të uzinës së ferrokromit Burrel, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë së të drejtës italiane "Darfo" s.p.a si dhe dhënies së disa stimuljeve dhe garancive për koncesionarin e kësaj marrëveshje*";
- B. Në vitin 2005, Shoqëria "Darfo" sp.a. u shndërrua nga shoqëri aksionare në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin Darfo s.r.l.; ë vitin 2010 Darfo s.r.l. ndryshoi emërtimin në ACR Holding s.r.l dhe në vitin 2016 ACR Holding s.r.l. ja transferoi Marrëveshjet Koncesionare shoqërisë Albchrome Holding Sh.p.k.;
- C. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është Ministria përgjegjëse për sektorin minerar dhe Autoritet Kontraktues në lidhje me koncesionet në këtë sektor, duke zëvendësuar kështu MEPP.
- Ç. Në vitin 2016 është nënshkruar Shtesa e Marrëveshjes së Koncesionit, e miratuar me Ligjin nr. 79/2016, duke e ndryshuar Marrëveshjen e Koncesionit (në vijim referuar bashkarisht si "**Marrëveshja Koncesionare**");
- D. Në vitin 2019 Koncesionari ka kërkuar zvogëlimin e objektit të koncesionit për Impiantin e seleksionimit Klos pasi nuk i shërben më qëllimit të koncesionit për shkak të ndryshimit të kushteve teknike dhe tregtare që nga projektimi i tij në vitin 1989;

DH, Palët njohin faktin se që në Impiantin e seleksionimit Klos janë realizuar dhe tejkaluar investimet e nevojshme sipas Marrëveshjes Koncesionare dhe përsëri nuk është arritur të vendoset në efikasitet, funksion të koncesionit, bazuar në qëllimet e Palëve;

ATËHERE:



Me qëllim heqjen e këtij objekti nga konçesioni dhe mundësimin e zhvillimit të tij nga subjekte të tjera publike apo private, për veprimtari të njëjta apo të ndryshme ekonomike, bazuar mbi kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1.

Kudo në Marrëveshjen e Konçesionit dhe Aneksat bashkëlidhur hiqen fjalët "Impianti i seleksionimit Klos".

Neni 2.

Në Nenin 5, të Marrëveshjes së Konçesionit bëhen këto ndryshime:

Pika 5.2 ndryshohet me tekstin si më poshtë vijon:

"Konçesionari merr përsipër të kryejë gjithçka që nevojitet për realizimin e Objektivit të Marrëveshjes që i është besuar, kushtet dhe afatet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, përveç Impiantit të Seleksionimit të Klosit, i cili i dorëzohet Autoritetit Kontraktues sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje.

Neni 3.

Brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Shtese Marrëveshje, Konçesionari do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues objektin "Impianti i Seleksionimit Klos", sipas inventarit të hartuar nga palët. Pajisja radioaktive matesi i densitetit "Rregulluesi automatik i densitetit të suspensës", administrohet dhe asgjësohet nga Konçesionari, në përputhje me rregullat dhe kushtet e sigurisë të përcaktuara nga kërkesat ligjore në fuqi për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues.

Neni 4.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në tre kopje dhe secila ka të njëjtën vlerë.

Kjo Marrëveshje, pas nënshkrimit të saj nga palët, hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Për Autoritetin Kontraktues

Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

me autorizim

Ilir Bejtja



Për Konçesionarin

Albchrome Holding shpk

Blerina Daka

Blerina Daka

ALBCHROME
holding

NIPT: L21220006C

